



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 30 dhjetor 2014, në mbledhjen e XII-të (dymbëdhjetë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç z. Mirsad Kamerollit dhe znj. Kadrije Mulolli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm, drejtorët e Drejtorive komunale, z. Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen me disa sqarime rreth kësaj mbledhjeje, dhe shtoi, për këtë mbledhje e cila është e fundit për këtë vit kemi menduar të kemi këto pika, gjithashtu një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi debatuar rreth këtyre pikave dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim, mirëpo nëse ndonjëri nga ju ka për të shtuar diçka, mund të merr fjalën.

z. Haki Rudari, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kam bërë vërejtje dhe po e paraqes edhe sot në këtë mbledhje, ne jemi kundër këtij rendi të ditës. Unë propozoj që këtij rendi të ditës t'i shtohet edhe një pikë, dhe ajo është: pyetje dhe përgjigje, me arsyetim se përmes kësaj pike ne do të jemi më afër qytetarëve, më afër Ekzekutivit të Komunës dhe do të ishte një lidhshmëri në mes këshilltarëve të Kuvendit, qytetarëve dhe Ekzekutivit të Komunës. Sigurisht se ka shumë pyetje për të cilat do të cilat është mundësia të jepen përgjigje të drejtpërdrejta, por ka edhe shumë pyetje që janë bërë dhe për të cilat ne këshilltarët po presim përgjigje.

Po ashtu në mbledhjen e KPF-së, e kam ngritur edhe çështjen, e cila është ngritur edhe në mbledhjen e kaluar të Kuvendit e cila ka mbetur që në një mbledhje të radhës të futet në rend dite, fjala është për kërkesën e këshilltares znj. Adelinë Stublla, që ka të bëjë me ndihmën që duhet t'ju dhënë nënave lehona, mirëpo kjo kërkesë në mbledhjen e KPF-së, një ditë më parë është hedh në votim dhe rezultati ka qenë 10 vota kundër, 1 votë për. Dua t'ju them se në shumë vende të botës ka ndihma në këtë drejtim, sidomos në rastet kur vërehet se kemi një zvogëlim të popullatës, mendoj se edhe ky migrim i qytetarëve që është duke u bërë ka ndërlidhmëni me atë kërkesë që këshilltarja e cekur i ka bërë Ekzekutivit të Komunës për t'i ndihmuar nënat lehona pas lindjes.

z. Fidan Rekalju, theksoi, mora fjalën me qëllim të sqarimit të opinionit dhe këshilltarëve të Kuvendit lidhur me diskutimet që janë bërë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa për çështjen të cilën e ngriti parafolësi, është e vërtetë që kemi diskutuar rreth kompensimit të nënave lehona, mirëpo të jemi shumë të qartë dhe korrekt, këshilltarë i nderuar (*i drejtohet parafolësit*), askush nuk ka qenë kundër stimulimit të nënave lehona, mirëpo sa i përket asaj që ne kemi votuar në parim kundër ka qenë shkak se projektbuxheti i Komunës është miratuar para rreth tre muajve, dhe siç jemi në dijeni të gjithë, po ai projektbuxhet i Komunës dhe buxheti i Kosovës në tërësi është miratuar nga Kuvendi i Kosovës, andaj ne si Komunë nuk kemi mundësi ta realizojmë propozimin e bërë për stimulimin e nënave lehona, propozim i cili është shumë i mirëpritur, dhe nuk është për tu anashkaluar asnjëherë, pra meqë ky propozim kërkon implikime buxhetore është mirë të bëhet në kohën e duhur në mënyrë që të mund të realizohet.

z. Kadri Avdiu, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa nga shefi i Grupit të këshilltarëve të LVV-së është kërkuar të futet në rend dite pika që ka të bëjë me stimulimin e nënave lehona, dhe në atë mbledhje kemi debatuar për këtë çështje por nuk kemi qenë kundër kësaj, mirëpo kemi kërkuar që kjo çështje të debatohet dhe të vendoset atëherë kur të ekzistojnë mundësitë e mbulimit me mjete buxhetore ky propozim, ngase tani nuk ekzistojnë mundësitë buxhetore, pra dua të them se ne nuk kemi qenë dhe nuk jemi kundër stimulimit të nënave lehona, ngase kjo çështje është diçka pozitive, dhe do të ishte absurde po të ishte kundër ndokush, por kemi kërkuar që ky propozim të bëhet me rastin e planifikimit të projektbuxhetit gjegjësisht miratimit të projektbuxhetit. Gjithashtu ne në mbledhjen e KPF-së kemi kërkuar të kemi vetëm një informatë rreth kësaj çështjeje, e jo të fusim në rend dite diçka që pastaj mund të vijmë në kundërshtim me vetveten ngase nuk kemi mundësi të mbulojmë financiarisht propozimin për stimulimin e nënave lehona të cilat lindin në territorin e Komunës së Podujevës.

znj. Adelina Stublla, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje kërkojmë që drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të jap shpjegim këtu sot para gjithë neve për pikën e ngritur në muajin prill, pikë që ka të bëjë me stimulimin e lehonave. Në fakt mua sot më është dhënë një shpjegim në formë të shkruar lidhur me këtë, nga drejtori i cekur, mirëpo unë kam kërkuar që shpjegimi të jepet për të gjithë këshilltarët e Kuvendit e jo vetëm për mua personalisht, sepse kjo çështje na intereson të gjithëve dhe është në të mirë të nënave, numri i të cilave që lindin në territorin e Komunës së Podujevës nuk është edhe aq i madh.

z. Bahri Selimi, theksoi, meqë shumë projekte po arsyetohen me mungesë të buxhetit, unë sot do t'i ngris dy çështje të cilat nuk kanë të bëjnë me buxhetin;

1-Meqë të gjithë ne e kemi parë gjendjen e rrugëve në territorin e Komunës tonë këto dytri ditët e fundit, kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, sot të na jap një informatë për gjendjen e rrugëve të Komunës së Podujevës, kontraktimit të kompanive për mirëmbajtjen e rrugëve dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me këtë fushë.

2-Sot po e ngris si çështje në mënyrë që të aprovohet për mbledhjen e radhës, përgatitja e një raporti të punës nga Komisioni për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc. Ne e kemi parasysh se ky komision ka pas të bëjë me një punë bukur të komplikuar dhe të vështirë, është bërë një punë e mirë dhe janë ndarë 50 shtëpi, mirëpo ajo punë dhe ajo listë e përfituesve nuk është paraqitur para Kuvendit, andaj mendoj se ja vlen që edhe këshilltarët e Kuvendit të njoftohen me ecurinë dhe rrjedhën e punës së Komisionit të cekur.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit jam i obliguar t'i jap disa sqarime rreth çështjeve të cilat u ngritën nga parafolesit, meqenëse përfaqësuesit e dy subjekteve të përfaqësuara në Komitetin për Politikë dhe Financa i dhanë sqarimet e nevojshme lidhur me propozimin e shefit të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, edhe unë do ta bëjë një gjë të tillë. Sa i përket stimulimit të nënave lehona përgjigja është dhënë sot nga drejtori i Drejtorisë përkatëse, ndërsa sa i përket asaj që në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje të përfshihet edhe pika, pyetje dhe përgjigje, unë mendoj se këtë e kemi të rregulluar me Rregulloren e Punës së Kuvendit përkatësisht në pikën të ndryshme çdo këshilltarë i Kuvendit mund të parashtroi pyetje Ekzekutivit të Komunës përfshirë edhe drejtorëve të Drejtorive dhe përgjigjet mund të jepen aty për aty ose në një mbledhje të radhës, pra konsideroj se nuk ka nevojë të bëhen ndryshime në rendin e propozuar të ditës për këtë mbledhje, gjithashtu rreth çështjeve të ngritura nga z.Bahri Selimi konsideroj se ka mundur të bëhen në pikën të ndryshme e cila është në kuadër të këtij rendi të ditës, andaj e hedh në votim rendin e propozuar të ditës sipas materialit të dërguar dhe rekomandimeve të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pas votimit u konstatua se me 28 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur, u miratua rendi i propozuar i ditës.

2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 14 nëntor 2014

znj. Adelinë Stublla, theksoi, sa i përket shqyrtimit të këtij ekstrakti të procesverbalit, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje kemi vërejtur se në pikën 9 (nëntë) të rendit të ditës është cekur se nuk ka pasur diskutime, kurse ne nuk pajtohemi me këtë, pasi që ka pasur diskutime, sidomos nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së, por nga Kryesuesi i Kuvendit nuk na është dhënë rasti që të kemi fjalën për diskutim, dhe që Kryesuesi këtë pikë të rendit të ditës e ka kaluar pa e hapur diskutimin dhe duke lëshuar seancën pasi që ajo zgjati shumë gjatë, dhe duke thënë se kemi për të shkuar në një varrim, gjë me të cilën ne nuk pajtohemi ngase pika, të ndryshme, nuk duhet që vetëm të figuroi në material, por ajo pike duhet të hapet për diskutim sepse në këtë pikë mund të ngritën shumë çështje të rëndësishme dhe në të mirë të qytetarëve.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, parafolesja e bëri këtë në formë të vërejtjes, mirëpo nuk di sa mund të inkorporohet kjo në procesverbal, por si do që të jetë incizimet e mbledhjeve ekzistojnë dhe kjo mund të vërtetohet.

z. Haki Rudari, theksoi, u përmend edhe nga parafolesja, por edhe në ekstraktin e procesverbalit i cili na është dërguar me material shihet se në pikën, të ndryshme, ceket se nuk pati diskutime. Unë them se diskutime ka pas, por që mbledhja është përfunduar, dhe pikërisht kjo është ajo që unë kërkoja para pak çastesh në këtë mbledhje që të kemi në kuadër të rendit të ditës një pikë, pyetje dhe përgjigje, para se të vihet te pika të ndryshme. Konsideroj se shumë nga ne këshilltarët nga të gjitha subjektet kemi pyetje dhe përgjigje, besoj se edhe këshilltarët nga radhët e LDK-së kanë pyetje, mirëpo sa i përket pikës, të ndryshme, pajtohem me parafolesën se realisht në çdo seancë po anashkalohet kjo pikë. Kështu që është mirë që kjo të jetë si vërejtje në mënyrë që në seancat e ardhshme të mos veprohet kështu, apo të futet pika, pyetje dhe përgjigje ose

në pikën të ndryshme të mos i ngutet askujt dhe të thuhet se mbledhja mbaroi, por të na jepet fjala për pyetje, kërkesa, e të tjera.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, është mirë që të mos ngatërrohen gjërat ngase procesverbal është i shkruar dhe në atë paraqiten kryesisht diskutimet e këshilltarëve, andaj nëse keni vërejtje në diskutimin e juaj mund të merrni fjalën dhe të paraqitni vërejtje në fjali, përfshirje apo mos përfshirje të diskutimeve ose një pjesë të diskutimeve apo të ngjashme, dhe nëse ato vërejtje janë me vend sigurisht se ne do t'i mirëpresim. Andaj e hedh në votim Ekstraktin e procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 14 nëntor 2014, me vërejtje eventuale që u paraqiten.

Pas votimit u konstatua se me 28 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua ky procesverbal me vërejtjet e paraqitura nga dy këshilltarët parafolës.

Sqarim:

Lidhur me vërejtjet e paraqitura, nga këshilltarët parafolës, në ekstraktin e procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 14 nëntor 2014.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës regjistrohen audio nga momenti që Kryesuesi i Kuvendit e hapë mbledhjen deri sa po i njëjti e mbyll atë, diskutimet e këshilltarëve dhe pjesëmarrësve tjerë të cilëve iu jepet fjala, nxirren në bazë të atij regjistrimi audio.

Andaj pas ridëgjimit të regjistrimit audio të mbledhjes përkatëse është verifikuar se në pikën e rendit të ditës, të ndryshme, nuk ka pasur diskutime.

3. Propozim vendim për miratimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2015

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ne në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi debatuar për këtë plan dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, plan i cili është hartuar në bashkëpunim me drejtorët e Drejtorive të Komunës gjegjësisht Ekzekutivin e Komunës, po ashtu për këto tema është pajtuar edhe Kryetari i Komunës pas konsultimeve që kemi pasur. Kështu që, të gjitha temat për muajt përkatës janë të parapara në këtë propozim plan, mirëpo nuk jemi të kufizuar vetëm në ato tema por kemi të drejtë t'i paraqesim edhe tema tjera që eventualisht paraqiten gjatë vitit sipas nevojave dhe sipas kërkesave të këshilltarëve të Kuvendit.

z. Fidan Rekalii, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim këtë propozim plan të punës së Kuvendit për vitin 2015, mendojmë se është një plan i mirë, por konsideroj se ne duhet të angazhohemi të gjithë së bashku në mënyrë që ky plan të zbatohet. Vlen të ceket se ky plan mund të plotësohet me pika tjera shtesë varësisht nga kërkesat ose propozimet e ndryshme të nevojshme që mund të bëhen me rekomandime nga Komitetit për Politikë dhe Financa, propozimet e këshilltarëve të Kuvendit, dhe propozimet e Ekzekutivit të Komunës.

z. Kadri Avdiu, theksoi, lidhur me planin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015, ne kemi diskutuar edhe një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, e që unë e falënderova dhe po e falënderoj edhe sot Kryesuesin e Kuvendit që më në fund e kemi një plan të punës së Kuvendit për vitin 2015, gjë e cila nënkupton që në periudhën e kaluar nuk kemi pasur plan të punës së Kuvendit, por kemi pasur vetëm orar të mbledhjeve. Pra ky plan është i mirëseardhur dhe ne do ta mbështesim këtë, mirëpo nuk do të thotë se nuk mund të futen edhe pika tjera varësisht

prej kërkesave, propozimeve, sugjerimeve e të tjera. E thash se ky plan është i mirëseardhur duke pasur parasysh që deri më tani nuk ka pasur plan të tillë Kuvendi i Komunës së Podujevës gjë për të cilën janë dhënë vërejtjet edhe më parë dhe më në fund është kuptuar se Kuvendi i Komunës duhet të ketë një plan të punës dhe të dihen temat të cilat do të shqyrtohen. Kryesuesi i Kuvendit e përmendi se gjatë përgatitjes së këtij plani është koordinuar edhe me drejtor të Drejtorive, andaj unë shpresoj që ky plan të mos anashkalohet por të zbatohet në përpikëri, si dhe të jetë funksional në mënyrë që në fund të vitit të jemi ne ata të cilët mund të japim vërejtje dhe vlerësim rreth zbatimit apo mos zbatimit të këtij plani.

z. Haki Rudari, theksoi, në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi diskutuar bukur gjatë rreth planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015, unë dua të përsërisë se ne si Grup vazhdimisht kemi kërkuar të kemi një plan të punës, madje kemi kërkuar që të kemi edhe një plan program të punës së Ekzekutivit të Komunës dhe Drejtorive të Komunës gjë e cila nuk ka ndodh, kështu që në parim e përkrahim këtë propozim plan të punës së Kuvendit për vitin 2015, mirëpo po të analizohet nga brenda ky plan shihet zbrazëtira dhe mangësi e që ne si Grup mendojmë se duhet të pasurohet më shumë ky plan.

Në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa u tha se për hartimin e këtij plani është punuar me Ekzekutivin e Komunës, madje u tha se është bashkëpunuar edhe me një këshilltarë nga radhët e PDK-së, gjë për të cilën ne konsiderojmë që për hartimin dhe përgatitjen e këtij plani është dashur të konsultohet apo të merr pjesë edhe një përfaqësues nga Grupi i këshilltarëve të LVV-së.

Vërejtjet tona në këtë propozim plan konsistojnë në atë, për arsye se në muajin janar nuk parashihet një informatë për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollorë, propozojmë që kjo pikë të futet në plan pune në muajin janar, propozojmë sepse mendojmë se nuk është diçka politike dhe ka përkrahje nga shumica. Pastaj në planin e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të cilin e kemi miratuar në këtë Kuvend thuhet, informimi i Kuvendit të Komunës dy herë brenda vitit për aktivitetet e KKSB-së, gjë e cila nuk ka ndodhur asnjëherë në vitin 2014 dhe ne si Grup i këshilltarëve kemi kërkuar pas rastit i cili ka ndodhur në fshatin Dumnicë ku është vrarë një qytetarë i Komunës tonë dhe një tjetër është arrestuar nga serbët, kurse ne nuk kemi marrë asnjë informatë nga ky Këshill. Pra unë konsideroj se këto dy propozime që i bëra duhet të inkorporohen në propozim planin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015, në mënyrë që të shkohet përpara.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me atë që e tha parafolësi se Kryesuesi i Kuvendit në KPF ka thënë se për hartimin e këtij plani kam bashkëpunuar edhe me një këshilltarë nga radhët e PDK-së, unë për hirë të së vërtetës dëshiroj të jap një sqarim, rreth kësaj çështjeje ka keqkuptim ngase plani i punës është hartuar në bashkëpunim me Ekzekutivin e Komunës, mirëpo një këshilltar nga radhët e PDK-së ka ardhur rastësisht në Zyrën time dhe e kam njoftuar që jemi në përfundim të hartimit të planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015, dhe ai këshilltar vetëm më ka përgëzuar për këtë plan, pra kjo ka qenë e tëra, e jo ashtu siç e tha parafolësi se gjoja ky plan është hartuar në bashkëpunim me një anëtarë nga radhët e PDK-së.

z. Kadri Avdiu, theksoi, konsideroj se shpjegimi i z. Haki Rudarit ishte në mënyrë jo të sinqertë, konkretisht thënia se rreth hartimit të këtij plani Kryesuesi i Kuvendit është konsultuar me një këshilltar nga radhët e PDK-së sa unë jam informuar Kryesuesi i

Kuvendit është takuar me z. Naim Çunakun me të cilin ka biseduar rreth mundësisë së mbajtjes së një takimi për disa pika të rendit të ditës dhe nuk ka pasur kurrfarë takimi për planin e punës së Kuvendit sepse këtë e bënë Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me Ekzekutivin e Komunës, prandaj mendoj se nuk bën të ndryshohet thënia e Kryesuesit të Kuvendit apo të jepen mendime tjera se gjoja është konsultuar LDK-ja me PDK-në, ngase kjo i bie që këto dy subjekte kanë koalicion në nivel qendrorë dhe ai koalicion është bartur edhe në nivelin lokal.

Unë, në cilësinë shefit të Grupit të këshilltarëve, ju siguroj se Partia Demokratike e Kosovës do të jetë transparente dhe do të jetë në nivel të detyrës së punës, pavarësisht koalicionit në nivel qendrorë, sepse në nivel lokal ne jemi opozitë dhe do të vazhdojmë me vërejtje sikurse deri më tani, aty ku ka vend për vërejtje ndërsa aty ku nuk ka vend për vërejtje apo që është punuar mirë e kemi thënë dhe do ta themi se është pozitive, e them këtë ngase opozita ka për detyrë të jap vërejtje me qëllim që Ekzekutivi i Komunës të përmirësohet dhe me këtë përmirësim përmirësohet jeta e qytetarëve. Pra edhe një herë po e përsërisë, të mësohemi t'i themi gjërat vetëm origjinal, ashtu siç janë, si dhe kërkoj nga Kryesuesi të sqaroj se nuk ka biseduar me këshilltarin e PDK-së për këtë plan, por ka biseduar rreth takimit të seancës, sepse këto dy gjëra kanë dallime.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë u kërkua nga parafolësi që unë të jap edhe një sqarim atë do të jap, është e drejtë e Kryesuesit të Kuvendit të konsultohet me cilindo këshilltar i cili mund të jap kontribut në lëmi të caktuara, dhe pajtohem plotësisht me atë që e tha z. Kadri Avdiu, dhe ju siguroj se nuk ka pasur diçka tjetër përveç asaj që e tha këshilltari i cekur parafolës, mirëpo edhe po të kishte konsultime me ndonjë këshilltar nuk e di se çka ka të keqe në këtë drejtim.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, për mua shqetësues është fakti që për 14 vite ky Kuvend ka punuar pa plan pune, mirëpo sido që të jetë ajo ka ndodhur dhe nuk kemi nevojë të kthehemi mbrapa, dhe është mirë që tani kemi një propozim plan të punës së Kuvendit për vitin 2015. Kryesuesi i Kuvendit e the se ky propozim plan është përgatitur në bashkëpunim me Drejtoritë e Komunës, mirëpo neve këshilltarëve na mungojnë informatat për planet dhe agjendat e drejtorëve të Drejtorive.

Në raportin e Auditorit të Përgjithshëm për vitin e kaluar kam vërejtur se jemi e vetmja Komunë e cila nuk kemi të ngritur nga Kuvendi i Komunës një komision për vlerësimin e ndarjes së subvencioneve në Bujqësi, e që është edhe obligim ligjor, mirëpo në atë raport është thënë se subvencionet janë ndarë direkt nga Kryetari i Komunës, andaj propozoj që për vitin 2015 kjo të merret parasysh dhe të ngritet nga Kuvendi një komision për vlerësimin e ndarjes së subvencioneve në bujqësi, gjithashtu në fokus të jetë edhe mundësia e gjetjes së një rruge ose linje buxhetore për kompensimin e komisioneve të Kuvendit të cilat jemi të detyruar t'i ngrisim, në mënyrë që kompensimi për anëtarët e atyre komisioneve të mos paraqes barrë financiare për Komunën, por të gjendet mundësia e ndarjes me kohë të një shume të buxhetit për këtë çështje.

z. Avni Ajeti, theksoi, edhe pse kjo që dua të them është jashtë kësaj pike të rendit të ditës, kërkoj mirëkuptim, por dua të jap një përgjigje rreth asaj që në fillim të mbledhjes e tha z. Bahri Selimi i cili kërkoi raport nga komisioni për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në fshatin Balloc. Unë në cilësinë e kryesuesit të atij komisioni mund të jap që tani një raport, kështu që lista e përfituesve ka qenë publike, dhe nuk e shoh të arsyeshme të lëshohet më shumë rreth kësaj sepse nuk e kemi në rend dite këtë pikë.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, meqë jemi në fund vit dhe në një atmosferë festive, nuk dua të lëshohem shumë rreth përmbajtjes së këtij propozim plani për të cilin jemi duke debatuar, mirëpo dëshiroj të inkurajoj Kryesuesin e Kuvendit për përgatitjen e këtij propozim plani, ngase siç e than edhe parafolësit është hera e parë që ky Kuvend ka para vetës një plan pune, por sa do i keq që mund të jetë ky plan më mirë është që ta miratojmë se sa të mos kemi fare plan të punës së Kuvendit.

Unë sot realisht kam pritur që të debatojmë edhe për rezultatet e arritura gjatë këtij viti dhe bilancet e punës si nga Ekzekutivi i Komunës, ashtu edhe nga Kryesuesi i Kuvendit. Këtë propozim plan e kam analizuar dhe nuk mund të mos i përmendi disa gjëra të cilat i kam vërejtur, së pari më vie mirë që edhe Grupi më i madh opozitarë është rënë në dakord me këtë plan, mirëpo esenca e këtij plani të punës është tendencë që ky Kuvend të kontrollohet në tërësi nga Ekzekutivi i Komunës dhe jo Ekzekutivi i Komunës nga ky Kuvend, e që kjo e dyte do të duhej të ishte. Jam në dijeni për kompetencat e Kuvendeve të Komunave ku ndikimet e tyre në zhvillim ekonomik dhe në mirëqenie nuk janë të mëdha, mirëpo megjithatë e kemi një përgjegjësi sepse ne jemi ata të cilët mund t'iu prijmë dhe t'i orientojmë këto gjëra si dhe të krijojmë praktika tjera të cilat për fatin e keq jo vetëm në Komunën e Podujevës por në gjithë shtetin e Kosovës janë krijuar politika që të kemi vetëm pushtetarë të pasur dhe qytetarë të pashpresë, por domosdo ne këshilltarët e Kuvendeve të Komunave jemi përgjegjës sepse fundja në një proces zgjedhorë i kemi vë para elektoratit emrat dhe fytyrat tona dhe jemi zotuar para tyre se do të jemi zë i tyre dhe do t'i përfaqësojmë interesat e tyre si dhe do të angazhohemi për transparencë dhe për mirëqenie, prandaj nga kjo që e thash kujtoj se na dalin obligime.

Kryesuesi i Kuvendit e tha se gjatë përgatitjes dhe hartimit të këtij propozim plani jam konsultuar me Ekzekutivin e Komunës, mirëpo dikasteret funksionale duken shumë pak në këtë plan të punës, dikastere për të cilat do të doja që të mos jenë vetëm formale por të jenë shumë më funksionale, e them këtë ngase në këtë propozim plan janë vetëm dy apo tri tema të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik për të cilat mendoj se është konsultuar me drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, ndërsa dikasteret tjera nuk duken shumë në këtë propozim plan.

Paraprakisht kërkoj mirëkuptim nga Kryesuesi dhe këshilltarët e këtij Kuvendi, mirëpo dua të ngris edhe një çështje jashtë kësaj pike të rendit të ditës, të gjithë jemi në dijeni se Nënkryetari i Komunës tani veç është Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe unë nga kjo foltore e inkurajoj Kryetarin e Komunës që në kohën sa më të shpejt të emëron Nënkryetarin e ri të Komunës dhe këtë jo vetëm që është obligim ligjor, mirëpo të gjithë ne jemi dëshmitarë të ngjarjeve dhe zhvillimeve në vend ku Kryetari i Komunës së Podujevës ka marrë një rol bukur të madh në politikëbërje nacionale dhe shtetërore dhe sigurisht se nuk do të ketë edhe shumë kohë të merret me problemet lokale, inkurajimit tim të mëparshëm për Kryetarin e Komunës ia bashkëngjis edhe këtë, ne si Llapjan që jemi të mos dëshmojmë diskriminim gjinorë por Nënkryetare të Komunës ta emëroj një zonjë, emërim që nuk do t'i bënte keq Ekzekutivit të Komunës, dhe për këtë iu bëjë thirrje edhe rrjetit të grave që të avokojnë në lidhje me këtë çështje.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, para se të hedh në votim këtë propozim dua t'i jap disa sqarime, ky propozim është plan i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015, dhe po e përsërisë atë që e kam thënë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, që USAID e ka hartuar një udhëzues rreth hartimit të

planeve të punës të Kuvendeve të Komunave të cilin ne e kemi marrë si model këtë dhe e kemi hartuar këtë propozim plan të punës ku të gjitha temat për të cilat me ligj është i obliguar Kuvendi t'i shqyrton ne i kemi paraparë, mirëpo kemi lënë mundësi që edhe tema të cilat nuk janë përfshirë në këtë dokument mund të përfshihen sipas nevojave dhe propozimeve të ndryshme qoftë nga Ekzekutivi i Komunës qoftë nga këshilltarët e Kuvendit dhe të tjera. z. Haki Rudari e përmendi çështjen lidhur me informatën nga Drejtoria e Arsimit, e që ne edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e cekëm që në mbledhjen e kaluar Drejtoria e Arsimit e ka bërë një informatë rreth Arsimit në Komunën e Podujevës, mirëpo në vitin 2015, me këtë propozim plan i kemi paraparë dy tema, dhe atë, për përfundimin e vitit shkollorë si dhe për përgatitjet për vitin e ri shkollorë, kështu që edhe tema tjera për të cilat mendoni që duhet të shqyrtohen do të përfshihen gjatë vitit sipas nevojave.

z. Haki Rudari, theksoi, në fillim e ceka se në parim e përkrahi këtë propozim plan të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2015, dhe i gëzohem faktit që kemi një propozim të tillë, mirëpo ishin dy propozime nga ana e Grupit tonë të këshilltarëve.

Unë këtu para vetës e kam një plan të punës të një Komune ku parashihet, raport nga përfundimi i gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollorë 2014/2015 dhe përgatitjet për gjysmë vjetorit e dytë të vitit shkollor, pra, përgatitjet për vitin e ri shkollor, përfundimi i gjysmë vjetorit të parë dhe përfundimi i vitit shkollor, dallojnë, si dhe pika e dytë që ne kërkuam të përfshihet në këtë propozim plan të punës së Kuvendit për vitin 2015 është, informatë nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi. Pra Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së ka këto dy propozime për përfshirje në këtë planë të punës; 1-informatë nga Drejtoria e Arsimit për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollorë, dhe 2 – informatë nga KKSB-ja, andaj kërkoj të hedhen në votim.

z. Shaban Osmani, theksoi, e përgëzoi Kryesuesin e Kuvendit për hartimin, në bashkëpunim me Ekzekutivin e Komunës, të këtij propozim plani të punës së Kuvendit për vitin 2015 në të cilin janë paraparë temat të cilat duhet të shqyrtohen gjatë vitit 2015, gjithashtu konsideroj se ky propozim plan në tërësi është mirë i përgatitur dhe i detajuar, por vlen të ceket se është lënë edhe mundësia që kurdo që paraqitet nevoja mund të përfshihen edhe tema tjera për shqyrtim. Lidhur me ndarjen e subvencioneve nga sektori i bujqësisë që u përmenden nga z. Rafet Llapashtica i cili e tha se Kryetari i Komunës i ndanë këto subvencione, unë them se nuk është e vërtetë që Kryetari i Komunës ndanë subvencione por është komisioni përkatës ai i cili merret me këtë çështje, përkatësisht me shqyrtimin e aplikacioneve.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje bëri dy propozime për përfshirje në plan të punës së Kuvendit për vitin 2015, unë i hedh në votim ato dy propozime.

Pas votimit u konstatua se me 13 vota për, 16 vota kundër, nuk miratohet propozimi i z. Haki Rudarit për përfshirje të dy temave në propozim planin e punës së Kuvendit për vitin 2015.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, tani e hedh në votim propozim planin e punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2015, sipas materialit të dërguar me rend dite.

Pas votimit, u konstatua se me 16 vota për, 3 vota kundër dhe 13 vota të përmbajtura u miratua propozimi i planit të punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2015.

4. Marrja e vendimit për kompensimin e Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, nënvizoi, lus këshilltarët e Kuvendit të cilët njëkohësisht janë edhe anëtarë të komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, që me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit, të mos marrin pjesë në mbledhje derisa të përfundon shqyrtimi i kësaj pike.

(Konstatohet se z. Avni Ajeti, z. Kadri Avdiu dhe z. Haki Rudari, këshilltarë të Kuvendit, njëkohësisht edhe anëtarë të komisionit përkatës: u larguan nga salla e mbledhjeve të Kuvendit, për arsye të shmangies së konfliktit të interesit.)

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, shtoi, ne edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi diskutuar për këtë propozim dhe kemi rekomanduar që shuma e kompensimit për anëtarët e komisionit të cekur të jetë nga 300 € për anëtarë.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, mora fjalën me qëllim që të jap një sqarim rreth kompensimit të anëtarëve të komisioneve të ngritura të Kuvendit të Komunës. Nuk e mohoj punën e asnjë komisioni të ngritur nga Kuvendi, mirëpo meqë jam drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, obligohem të sqaroj këtë çështje ngase kompensimi i anëtarëve të komisioneve të ndryshme të Kuvendit është duke u bërë dukuri, dhe për mua qenësore është që kompensimet e tilla të kenë mbështetje ligjore. Lidhur me këtë çështje unë këtu e kam edhe Udhëzimin Administrativ i cili përcakton pagesat e stafit politik në Komuna ku përfshihen edhe këshilltarët e Kuvendit, mirëpo askund nuk figurojnë komisionet, përveç Komiteteve obligative të cilat paguhen, gjithashtu nuk kam hasur askund në ndonjë dispozitë ligjore sipas së cilës mund të ketë mbështetje ligjore një vendim i cili miratohet në Kuvend, sipas së cilit duhet të paguhen anëtarët e komisioneve të ngritura nga Kuvendi i Komunës, prandaj më duhet ta them se vendimet e tilla mund të mos kenë bazë ligjore. Po e përsëris se pa dashur të mohoj punën dhe rëndësinë e asnjë komisioni, mirëpo të gjithë jemi dëshmitarë që në këtë Kuvend e kemi miratuar linjën buxhetore për paga dhe mëditje të Kuvendit të Komunës së Podujevës ku janë të parapara seancat e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe mëditjet për Komitetet obligative, ndërsa nuk ka planifikim për pagesa tjera, prandaj me këtë sqarim dua ta heq përgjegjësinë qysh sot nga vetja, që në qoftë se pagesa të tilla do të ketë gjatë vitit 2015 nga linja buxhetore për pagesa të rregullta të këshilltarëve të Kuvendit, të mos mbetem unë përgjegjës, e them këtë ngase nëse ndodh që ndonjë pagesë e rregullt për këshilltarët e Kuvendit të mos bëhet, atëherë me siguri se secili nga ju do të drejtohet me pyetje nga unë. Pra nuk jam kundër pagesave ose kompensimeve

të tilla për komisione të Kuvendit, mirëpo jam për atë që këto kompensime të kenë mbështetje ligjore, qoftë me ndonjë Udhëzim Administrativ, qoftë me ndonjë Rregullore, qoftë me ndonjë ligj, vetëm të mbështeten pagesat e këtyre komisioneve në mënyrë që të mos miratojmë vendime të cilat mund të jenë ndesh me vetveten, sepse mund të miratohen vendime të cilat kanë implikime financiare kurse nuk jemi në dijeni se a ka apo nuk ka bazë ligjore. Lidhur me këtë shpresoj se në mesin e juaj ka edhe jurist me profesion të cilët do të mund të më ndihmonin mua në këtë drejtim. Pra edhe njëherë po e përsëris, nuk kam kurrfarë tendence mirëpo vetëm dua të sqarohemi rreth buxhetit të miratuar, ligjeve dhe akteve tjera nënligjore në fuqi në mënyrë që vendimet të merren konform tyre, por nëse bëhen pagesa ose kompensime të komisioneve të kuvendit pa mbulesë financiare, kurse në anën tjetër në qoftë se gjatë vitit mbeten pa ndonjë pagesë të rregullt këshilltarët e Kuvendit, unë nuk mbaj përgjegjësi.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e falënderoj drejtorin parafolës për sqarimet që i bëri, meqë është përgjegjës për financat e Komunës sigurisht se është i obliguar të kërkon bazë ligjore për kompensimin e anëtarëve të komisioneve të ngritura nga Kuvendi i Komunës.

Vlen të ceket se ky propozim është përfshirë në rend dite për këtë mbledhje pasi që komisioni përkatës për shkak të punës së ngarkuar që ka pasur ku ka mbajtur mbi 30 takime dhe ka pasur telashe të ndryshme, gjë për të cilën edhe unë pajtohem se nuk ka qenë fare punë e lehtë, pastaj anëtarët e këtij komisioni kanë tentuar ta ndërpresin punën për shkak të mos kompensimit të tyre, mirëpo kanë kërkuar nga unë t'iu garantoj se propozimi për kompensim e këtij komisioni do të jetë pikë e rendit të ditës në këtë mbledhje, pra kjo na ka shtyrë që kjo të jetë pikë e rendit të ditës në këtë mbledhje.

Gjithashtu ju njoftoj se në një takim të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave, përfaqësuesve të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës, e kemi ngritur çështjen rreth pagesave të komisioneve të Kuvendeve të Komunave, në shumicën e Komunave komisionet paguhen me vendim të Kuvendit mirëpo pagesa bëhet nga fondi i pagave të këshilltarëve të Kuvendeve të Komunave përkatëse, prandaj pajtohem me drejtorin parafolës i cili e tha se në qoftë se vazhdohet me vendime të tilla është e mundshme të rrezikohen pagat e rregullta të këshilltarëve të Kuvendit, ngase jemi në dijeni se buxheti për pagat e këshilltarëve të Kuvendit është i miratuar për 12 seanca. Ministria e cekur ka premtuar se shumë shpejt do të nxjerrët një Udhëzim i cili do të rregullon pagesën e komisioneve të Kuvendeve.

Pra duke pasur parasysh arsyetimet që i ceka më lartë e kemi parë të arsyeshme që ky propozim të përfshihet në këtë rend dite për këtë mbledhje, propozim për të cilin kemi diskutuar edhe në KPF dhe i kemi rekomanduar Kuvendit ta shqyrton mundësin e kompensimit të anëtarëve të këtij komisioni në shumë 300 € për secilin anëtar, një anëtar i komisionit është shërbyes civil dhe pagesa do t'i bëhet nga kategoria paga dhe mëditje.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet kompensimin në shumë 300 € për anëtarët e komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në fshatin Balloc, gjë për të cilën jemi pajtuar të gjithë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, mirëpo është mirë dhe është e nevojshme të gjendet arsyeshmëria ligjore e këtyre vendimeve.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, e dëgjova me vëmendje drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, thënë të drejtën ne edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kemi debatuar rreth përputhshmërisë ligjore të vendimeve të tilla në raport me

financat, gjithashtu ne kemi qenë në dijeni se nuk ka buxhet të ndarë për kompensime të anëtarëve të komisioneve. Nëse ky komision duhet të kompensohet nga buxheti i ndarë për Kuvendin e Komunës nuk jam në dijeni tani për tani për linjën buxhetore përkatëse se a ka apo nuk ka suficit të buxhetit në mënyrë që të kompensohen anëtarët e këtij komisioni, mirëpo në qoftë se eventualisht iu ndalet ndonjë pagë këshilltarëve të Kuvendit për arsye të kompensimit të këtij komisioni, konsideroj se nuk mund të ketë përputhshmëri ligjore. Prandaj kam propozuar që, nëse ky Kuvend mendon të punoj në vitet e ardhshme me komisione, është e nevojshme të gjen linjën buxhetore për pagesën e komisioneve të ngritura nga Kuvendi në mënyrë që Ekzekutivi i Komunës gjegjësisht Drejtoria e Buxhetit dhe Financave kompensimet e tilla të bëhen duke pasur arsyeshmëri ligjore, por edhe ne si Kuvend të miratojmë vendime të bazuara në ligje përkatëse, e jo të na ndodh të miratojmë vendime të cilat nuk mund të zbatohen për shkak të mos arsyeshmërisë ligjore. Kështu që ne mund ta votojmë këtë propozim vendim sot, mirëpo problemi qëndron që në të ardhmen do të kërkojnë të gjitha komisionet e Kuvendit të kompensohen dhe ne nuk mund t'ia mohojmë të drejtën për kompensim asnjërit prej tyre. Kërkoj që t'iu tregohet anëtarëve të këtij komisioni që ne po e votojmë këtë vendim sot mirëpo pagesa do të bëhet pasi të gjendet linja buxhetore dhe arsyeshmëria ligjore e vendimit, e them këtë ngase anëtarët e komisionit përkatës mund të mendojnë që pagesa do t'iu bëhet menjëherë.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, theksoi, dëshiroj të jap edhe një sqarim të shkurtër rreth kësaj çështjeje, pagesa e këtij komisioni do të bëhet me pagesat e muajit janar të vitit 2015, për shkak se pagesat e vitit 2014 kanë përfunduar dhe nuk mund të bëhen, prandaj kjo shumë e cila me siguri se do të procedohet sot për pagesë e rëndon buxhetin e vitit 2015. Në vitin 2014 ka qenë një lloj vakumi ligjor ku siç jeni në dijeni janë rritur pagat për 25% dhe asnjë linjë buxhetore nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm për pagesa me rritje prej 25% dhe atë mungesë të atij buxheti e ka kompensuar Qeveria e Kosovës me kompensime të cilat i ka pasur në linja të veçanta, mirëpo kjo nuk do të ndodh në vitin 2015 ngase në këtë vit ne duhet të zbatojmë atë që është miratuar në këtë Kuvend, andaj nëse ka ndryshime të cilat kanë implikime në financa atëherë ne duhet të dijmë ku të gjejmë mjete financiare për ta rritur fondin, ndërsa linja tjera buxhetore nuk mund të shtohen, pra për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me Kuvendin e Komunës është linja buxhetore për Kuvendin e Komunës, kurse për pagesa të mëditjeve të këshilltarëve të cilët kanë pasur ftesa për udhëtime zyrtare jashtë vendit, ata janë paguar nga linja buxhetore mallra dhe shërbime, raste të tilla kemi pasur në vitin 2014, mirëpo nuk mund ta ngarkojmë asnjë linjë buxhetore që është në kundërshtim me Ligjet, Rregulloret ose me Udhëzime për shërbyesit civil apo të këshilltarëve të Kuvendit.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, mendoj se të gjithë ne pajtohemi me sqarimet që i japi drejtori parafolës dhe konsideroj se ashtu siç tha drejtori ashtu edhe është, mirëpo unë e njoftoj komisionin përkatës se pagesa do t'iu bëhet pas vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, gjithashtu Ministria e Financave edhe përkundër këtij vendimi që ne po e miratojmë sot, mund të mos e miratoj këtë kompensim, prandaj këto dy çështje të mbesin si konkluzion.

Pas votimi u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i vendimit për kompensimin e anëtarëve të komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, sipas rekomandimit të Komitetit për Politikë dhe Financa.

5. Të ndryshme

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me kërkesat, pyetjet dhe çështjet tjera që u paraqiten në fillim të kësaj mbledhjeje, përgjigjet ose sqarimet mund të jepen sot, por nuk janë të obliguar për këtë, mirëpo nëse nuk janë të gatshëm për këtë mbledhje ato përgjigjet do të jepen me shkrim në mbledhjen e ardhshme.

znj. Florije Maliqi, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës, kërkoj nga drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale që në seancën e ardhshme të raportoj para Kuvendit për gjendjen e shëndetësisë gjatë këtij viti në Komunën tonë.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, çështja që duam të ngrisim ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje është çështja dedikuar Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ku ne si Grup kemi kërkesa nga ana e prindërve që fëmijët e tyre të kenë kontrolla mjekësore në shkollat e qytetit dhe të fshatrave, kur dihet se shëndeti është mbi të gjitha.

Pasi më nuk pati të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi i Kuvendit e përfundoj mbledhjen duke iu uruar vitin e ri 2015 të gjithëve.

Mbledhja përfundoi në orën 11;05

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-006-101838
Podujevë,
30 dhjetor 2014**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**